



Prishtinë: 19.05.2016
Kodi i ZRRE-së: V_818_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1458_03_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **22.03.2016**.

në seancën e mbajtur më datë 19 maj 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh. R. me shifër DPR- 43372 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1458_03_16** i datës 07.03.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 22.03.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Sh.R. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: Konsumatori ka kërkuar që vendimi i DMK-së duhet të rishikohet edhe njëherë për faktin se ndërmarrja e energjisë KESCO më ka ngarkuar në mënyrë paushalle në vlerë financiare prej 900€. Konsumatori në ankesë ka dhënë arsyet se për situatën e krijuar janë fajtorë vetë punëtorët e autorizuar të KEDS. Konsumatori kërkon që Bordi të më shkarkoi nga paushalli i ngarkuar dhe të më ngarkoi me vlerën reale në vlerë prej 150€.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.02.2014 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2014 me shpenzim prej **8,077 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **895.08€**. Lidhur me këtë konsumatori me datë 25.03.2015 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë.

Pas kësaj Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 27.04.2015 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 0002115 datë 22.10.2014. Gjithashtu në përgjigjen e KESCO është theksuar se faturimi është konform rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.



I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-së, konsumatori me datë 28.04.2015 i është drejtuar DMK/ZRRE me ankesë me të cilën ka apeluar përgjigjen e KESCO-së dhe ka kërkuar që ti shlyhet borxhi i ngarkuar sipas tij në mënyrë paushallë. DMK/ZRRE, pas shqyrtimit e ankesës së konsumatorit me datë 07.03.2016 ka marr vendim me të cilën ka aprovuar ankesën e konsumatorit duke e detyruar KESCO që të bëjë korrigjimin e faturave për periudhën shtator 2013 deri në periudhën janar 2014 në vlerë **-105.20€** duke bërë shpërndarjen e kWh për periudhën pesë mujore (09/2013 -01/2014).

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit Sh.R. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë me të drejt ka vërtetuar gjendjen faktike ku ka konstatuar se konsumatori për periudhën kontestuese nuk ka lexim dhe faturim të saktë të shpenzimeve mujore. Sipas rrjedhës së energjisë është konstatuar se konsumatori nuk ka lexim dhe faturim të saktë për periudhat shtator 2013 deri në periudhën janar 2014 kur edhe është faturuar konsumatori me shpenzim të energjisë elektrike (kilovatorë – kWh) të grumbulluar

Bordi i ZRRE-së, ka analizuar edhe procesverbalin nga laboratorit i kalibrimit dhe protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 04657581 dhe nga kjo ka vërtetuar se njehsori elektrik ka bërë matje të saktë të shpenzimeve dhe është brenda kufijve të lejuar të gabimit dhe është në përputhje me kufirin e pasaktësisë të përcaktuar me kodin e matjes, përkatësisht neni 4.11.1.

Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të ankesës së konsumatorit ka konstatuar se KESCO nuk ka respektuar nenin 23 përkatësisht paragrafin 3 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike ku thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Andaj mbi këtë bazë Bordi ka vërtetuar se organi i shkallës së parë DMK/ZRRE ka korigjuar me të drejtë periudhën e faturimit paushallë të bërë nga ana e KESCO-së.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në menyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe është bërë korigjimi i konsumatorit nga DMK/ZRRE në përputhje me dispozitat e nenit 23 paragrafi 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 19.05.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Sh.R.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.